

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rusia sulmon Ukrainën, teksa Zelensky thotë se Moska s'është e gatshme t'i japë fund luftës
ADRESA	https://dosja.al/bota/rusia-on-ukrainen-teksa-zelensky-thote-se-moska-seshte-e-gatshme-t-i-jap-i516338
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:44:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e3ac40b797b69141bb98a594b7f035391834169fcbdc04e576b64021fdd88a1
TEKSTI	bf4a7cc3369ccb2c69d2efa2a783df8d647183d28e05b19abf3a8892bd2044e4
PAMJA	9ddab14275722d2aedc9650ad5bfaab56f6473b3d8664d258425539bfc78776

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d216f8eb611758c22d73db123a3a53dee6758de54b3f943617d1d99a816ec515
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afd89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d216f8eb611758c22d73db123a3a53dee6758de54b3f943617d1d99a816ec515>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARE

Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale

18 ORE ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

20 ORE ME PARE

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

1 DITE ME PARE

Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar

Bota

Rusia sulmon Ukrainën, teksa Zelensky thotë se Moska s'është e gatshme t'i japë fund luftës

Në Kiev, një burrë u vra kur një dron rus goditi një ndërtesë në qarkun Sollomianski, njoftoi Shërbimi Shtetëror i Emergjencave të Ukrainës.



27 Shtator 2026, 15:31
Nga G.M



Zjarfikësit në një treg të dëmtuar pas sulmeve me dronë të Rusisë në Zaporizhja të Ukrainës më 26 shtator 2026.

Sulmet me dronë rusë vranë të paktën katër persona në Ukrainë gjatë natës dhe në orët e para të 27 shtatorit, përfshirë një person në kryeqytetin Kiev dhe tre në rajonin juglindor të Zaporizhjes, thanë zyrtarët ukrainas. Në Kiev, një burrë u vra kur një dron rus goditi një ndërtesë në qarkun Sollomianski, njoftoi Shërbimi Shtetëror i Emergjencave të Ukrainës.

Një zjarr shpërtheu në një objekt për riparimin e automjeteve në të njëjtin qark, ndërsa u godit edhe një ndërtesë tjetër, tha agjencia. Ajo publikoi pamje që tregonin zjarfikësit duke luftuar me zjarret në ndërtesat e dëmtuara.

Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, tha se një sulm rus në qarkun Shevçenkivski plagosi një grua dhe dy fëmijë 16-vjeçarë. Të tre u dërguan në spital, sipas tij. Në rajonin e Zaporizhjes, në juglindje të Ukrainës, tre persona u vranë nga sulmet ruse, sipas administratës ushtarake rajonale.

Një burrë u vra në fshatin Komishuvaka, ku një shtëpi u shkatërrua dhe disa të tjera u dëmtuan, tha administrata. Dy persona të tjerë, një burrë dhe një grua, u vranë kur një sulm rus goditi makinën e tyre në fshatin Novotavrijske. Katër persona u plagosën, ndërsa në sulmin ndaj Komishuvakës, sipas administratës ushtarake rajonale.

Trump i thotë Kievit ta "zgjidhë" luftën

Ndërkohë, presidenti amerikan, Donald Trump, nuk pranoi të konfirmonte se kishte rënë dakord që Ukraina të prodhonte raketa Patriot, pavarësisht deklaratës së presidentit ukrainas, Volodymyr Zelenskyy më 25 shtator se Trump kishte marrë një "vendim përfundimtar" për t'i dhënë Kievit licencë për prodhimin e raketave amerikane të mbrojtjes ajrore.

I pyetur më 26 shtator për marrëveshjen për Patriotët, presidenti Trump tha se dëshironte që Zelensky dhe

editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Në vëmendje

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:45

Xing në Rinas/ Rama vjen nga SHBA, Berisha largohet për në Strasburg (VIDEO)

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:38

Çfarë po ndodh në Rinas?
Rama lë gazetarët jashtë
dhe anulon konferencën,
video-mesazhi shpërndahe
me regji nga Kryeministria

presidenti rus, Vladimir Putin, ta “zgjidhnin” luftën e tyre. Rubio konfirmon bisedimet me Ukrainën për Patriotët - eksportet paralajmërojnë se prodhimi është vite larg Trump dhe Zelensky u takuan në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork më 22 shtator.

“Folëm për shumë tema të ndryshme dhe për shumë prej tyre... kishte pajtim të fortë”, u tha Trump gazetarëve lidhur me këtë takim.

“Por, e dini çfarë dua që të bëjë ai? Të arrijë një marrëveshje. Dua që ai ta zgjidhë çështjen me Putinin dhe dua që Putini ta zgjidhë çështjen me të”.

Zelensky tha pas takimit se shpreson që Uashingtoni të ndihmojë në përfundimin e luftës “sa më shpejt të jetë e mundur”. Ai gjithashtu i ka bërë thirrje Trumpit të vazhdojë presionin ndaj Moskës, përfshirë përmes sanksioneve të reja.

Zelensky: Putini kërkon justifikime për të vazhduar luftën

Në adresimin e tij të përnatshëm, Zelensky tha se Moska nuk po tregon shenja se është e gatshme t'i japë fund luftës kundër fqinjit të saj dhe u bëri thirrje vendeve perëndimore të qëndrojnë të bashkuara në përpjekjet për ta detyruar Kremlinin që të ulet në tryezën e negociatave.

“Është e qartë se rusët nuk po përgatiten ta ndalin luftën e tyre, të paktën jo tani”, tha Zelensky, duke iu referuar raporteve të inteligjencës se Moska synon të rrisë shpenzimet për prodhimin e dronëve me motor reaktiv dhe municioneve të tjera.

Putini “gjithmonë gjen ndonjë justifikim të dobët – për të mos u takuar, për të mos zhvilluar një takim trepalësh, për të mos biseduar, për të mos i dhënë fund luftës, për të mos e ndalur vrasjen”.

“Me të, situata është njësoj për vite të tëra, dhe të gjithë partnerët tanë e ndiejnë këtë. Ai po kërkon justifikime për të vazhduar luftën. Gjithmonë tingëllon njësoj, dhe takimi ynë i fundit me presidentin amerikan e tregoi këtë”, shtoi Zelensky në fjalimin e 26 shtatorit.

“Zgjerimi i luftës”

Udhëheqësi ukrainas pretendoi se Rusia planifikon të shpenzojë 12 miliardë dollarë gjatë vitit të ardhshëm vetëm për prodhimin e “dronëve me motor reaktiv dhe municioneve, vetëm për këtë kategori armësh”.

“Ky është shqetësim i drejtpërdrejt edhe partnerët tanë. Shumë shërbime të inteligjencës kanë informacione se rusët duan ta zgjerojnë luftën, aktivitetet e tyre, në më shumë vende. Ndoshta edhe në rajone të tjera. Prandaj, duhet ta ndërtojmë mbrojtjen së bashku. Prandaj, duhet të mbrohemi së bashku, në mënyrë parandaluese”.

Ai tha se mbrojtja ajrore ukrainase ka mundur të pengojë 55 për qind të dronëve me motor reaktiv të lëshuar nga Rusia, ndërsa sulmet gjatë natës ndaj Kievit dhe qyteteve të tjera janë bërë gjithnjë e më të shpeshta me fillimin e motit të ftohtë.

“Po punojmë për këtë së bashku me Amerikën, Evropën, Kanadanë, Japoninë dhe shumë të tjerë në mbarë botën që po na ndihmojnë, po e ndihmojnë Ukrainën, po i ndihmojnë njerëzit tanë”, shtoi ai.

Zelensky shkroi në rrjetet sociale se “i kërkojmë presidentit Trump të zbatojë Aktin Lindsey Graham ndaj Rusisë dhe të gjithë atyre që e mbështesin financiarisht luftën e saj”. Ligji, i nënshkruar nga Trumpi një javë më parë, i jep presidentit kompetenca të reja të gjera për të vendosur sanksione dhe tarifa ndaj Rusisë, sektorit të saj energjetik, si dhe qeverive dhe entiteteve të huaja që e ndihmojnë Moskën t'u shmanget kufizimeve ekzistuese.

Presidenti ukrainas u tha gazetarëve në Nju Jork se Uashingtoni kishte propozuar mbajtjen e asaj që do të ishte takimi i parë Ukrainë-Rusi-SHBA në shumë muaj, në një nivel relativisht të ulët “teknik”, me Emiratet e Bashkuara Arabe si mikpritëse. Nuk pati konfirmim të menjëhershëm nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Putini tha se të gjitha propozimet për paqe janë “në tavolinë”, por shtoi se Moska duhet t'i peshojë interesat e saj.

Më shumë sulme ndaj infrastrukturës

Agjencia franceze e lajmeve AFP tha se një analizë e të dhënave nga një monitorues i konfliktit tregon një rritje të ndjeshme të sulmeve ndaj infrastrukturës së Ukrainës gjatë muajve të fundit. Sipas AFP-së, të dhënat e përpiluara nga Armed Conflict Location and Event (ACLED) tregojnë se Rusia ka goditur dy herë më shumë depo në rajonin e Kievit gjatë tre muajve të fundit sesa në të gjitha vitet e mëparshme të luftës të marra së bashku.

ACLED ka regjistruar rreth 100 sulme ose seri sulmesh ndaj objekteve civile të magazinimit në rajonin e Kievit që nga mesi i qershorit, krahasuar me vetëm 50 nga shkurti i vitit 2022 deri në mesin e qershorit të këtij viti./REL

VIDEO/ Me destinacion Greqinë, kapen 91 kg drogë në Kakavijë

më të klikuarat

Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

Shpresë për familjen Kotorri/ Emisioni italian publikon foton e ngjashme me Rajmonda Kotorrin që u zhduk 16 vjeçe në Itali

Shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, goditen disa grupe! 31 të arrestuar, 14 të tjerë në kërkim (VIDEO)

Eriselda Sefa e korrigjon këngën për Enver Hoxhën me Cilevion, reper i koncert falas në Lushnjë

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Sondazh

Poll

Raport

27 Shtator 2026, 15:29

Arrestime pranë bazës ajrore britanike të përdorur nga SHBA-ja në luftën me Iranin

Një bombardues amerikan në bazën ajrore RAF Fairford. Fotografia ilustruese nga arkivi. Policia britanike ka arrestuar disa persona nën ...

Kongresisti republikan i kërkon Partisë Popullore Evropiane t'i ndërpresë lidhjet me partinë e Vuçiç: Të ketë zgjedhje të lira në Serbi

Raport

27 Shtator 2026, 14:18

SHBA: Masat e reja ekonomike ndaj Iranit janë të suksesshme

Raport

27 Shtator 2026, 14:08

"200 metrat" që liruan Gotovinën dhe mësimi për katërshen e UÇK-së

Raport

27 Shtator 2026, 12:59

Trump refuzoi propozimin për Hormuzin, Teherani: Vetëm diplomacia i jep fund konfliktit

BE-ja nuk bojkoton samitin e G20-së pas ftesës për Putinin

Putin dhe Trump Presidenti amerikan Donald Trump e ka ftuar zyrtarisht presidentin rus Vladimir Putin në samitin e G20-së. Ftesa u përcoll n...

Incident pranë bazës ajrore britanike RAF Fairford, evakuohen banorët dhe arrestohen disa persona

Stradner: Kremlini mund ta ndihmojë Vuçiqin me energji

Meshë madhështore në Paris, Papa mbledh gati 1 milion njerëz

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë zbardh takimin me Sergej Lavrov: Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin

MË SHUMË



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.